



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI ✓

Nr. 3818 Prot.

Tiranë, më 11.10.2024

**Lënda:** Kërkesë për marrjen e masës disiplinore ndaj Deputeteve Erion Brace, Ilir Metaj dhe Plarent Ndreca.

**Baza Ligjore:** Neni 63, pika "a" dhe Neni 65/1 i Rregullores së Kuvendit; Neni 6 i Kodit të Sjelljes së Deputetit.

**Drejtuar:** Znj. Klotilda BUSHKA  
Kryetare e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën

**Këtu**

Znj. Bushka,

Me vendimin nr. 19, datë 21.03.2024, Kuvendi i Shqipërisë ka vendosur: "1. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Shërbimin Publik të Sterilizimit dhe Shërbimin Publik të Check-Up në Shëndetësi.". Në pikën VI të këtij vendimi është përcaktuar: "Komisioni Hetimor do të zhvillojë veprimtarinë e tij për një afat kohor 4-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi". Me kërkesë të Komisionit Hetimor, ky afat u shty deri në datë 22 tetor 2024.

Komisioni ka nisur punën e tij përmes shumë problematikash, bojkotimit të mbledhjeve dhe vonesave të qëllimshme nga ana e mazhorancës, tentative të një pas njëshme për uzurpim të drejtimit të Komisionit, votime antiligjore me firma në protokoll, shkelje të një pas njëshme procedurash përcaktuar në ligjin për Komisionet Hetimore dhe Rregulloren e Kuvendit. Problematika të evidentuara nga deputetët e opozitës në Komision e për të cilat është njoftuar Kryetarja e Kuvendit znj. Nikolla, Kryetari i Grupit Parlamentar të PS z. Cuci, si dhe Trupit Diplomatik në Shqipëri, si znj. Spiropali tashmë.

Me fillimin e sesionit të ri parlamentar në shtator, vihet re një tentativë tjetër e deputetëve të mazhorancës në Komisionin Hetimor për të minuar dhe pamundësuar vijimin normal të Komisionit.

Edhe pse ky Komision është kërkuar me forcë nga ana e opozitës parlamentare, nënkryetari i Komisionit z. Ndreca dhe deputetët e mazhorancës kanë ndërmarrë vendime të njëanshme, të padakortësuar, arrogante, të cilat kanë dëmton rëndë ecurinë e punës së Komisionit Hetimor. Disa nga shkeljet nga ana e deputetëve të mazhorancës janë:

- 30 shtator 2024: Thirrja e mbledhjes së Komisionit pa dëshmitarë. Asnjë prej dëshmitarëve nuk kishte konfirmuar pjesëmarrjen. Kërkesat e përsëritura nga ana e Kryetares së Komisionit dhe deputetëve të opozitës, nuk u morr parasysh. Nënkryetari z. Ndreca dhe Sekretari z. Xhoxhi, vijuan mbledhjen në mënyrë të njëanshme pa asnjë dëshmitar duke shkelur dakortësinë dhe konsensusin e arritur në Komision;
- 2 tetor 2024: Thirrja në mënyrë të njëanshme, me vendim të vetëm Nënkryetarit Ndreca dhe Sekretarit Xhoxhi, e dëshmitarëve të pa propozuar, të pa dakortësuar, të pa votuar në



Komision. Kjo cënon rëndë integritetin dhe besueshmërinë e Komisionit Hetimor i cili ka procedura të përcaktuara saktë, dhe qartë në ligjin për Komisionet Hetimore.

- 8 tetor 2024: Edhe pse me kalendar të miratuar, deputetët e maxhorancës, pa asnjë komunikim me Kryetaren e komisionit, në shkelje të dakordësisë së arritur më parë, thërrasin mbledhjen e Komisionit me rend të ditës seancë dëgjimore me 5 dëshmitarë drejtues dhe ish drejtues të administratës së Ministrisë së Financave.
- o Kërkesa e firmosur nga ana e disa deputetëve të maxhorancës në Komision, është në shkelje të cdo procedure dhe Nenit 32 pika 2 e Rregullores. Kërkesa e deputetëve të PS nuk i adresohet Kryetarit të Komisionit qartazi duke refuzuar njohjen nga ana e tyre të autoritetit të tij e duke tentuar uzurpimin e komisionit dhe vendimmarrjes së tij. Kjo shkresë nuk ka ardhur në rrugë zyrtare te Kryetari i Komisionit, i cili në bazë të Nenit 32 pika 2 e Rregullores është i detyruar të mbledhë komisionin sipas kërkesës. Ky, është një akt i qëllimshëm, nga ana e deputetëve të maxhorancës, të cilët kërkojnë të minojnë punën e komisionit e ta dështojnë dhe pengojnë hetimin parlamentar. Në një komision hetimor, që funksionon me ligj të posacëm, nuk mundet të lihet jashtë e të mënjanohet pjesëmarrja e opozitës e cila ka kërkuar hetimin parlamentar për dy koncesionet në shëndetësi. Megjithë anomalitë dhe pengesat e një pas njëshme, deputetët e opozitës u paraqitën në mbledhjen e komisionit. Vlen të përmendet fakti që Nënkryetari i Komisionit ishte bërë gati për të filluar mbledhjen dhe kishte thirrur edhe dëshmitarin edhe pse Kryetari i Komisionit dhe deputetët e opozitës ishin paraqitur në komision sipas kërkesës (në shkelje të Rregullores së Kuvendit) të deputetëve të maxhorancës.
- o Vendosja e Gardës së Republikës në dyert e Sallës ku do të zhvillohej mbledhja e Komisionit hetimor. Garda, me një shkresë nga sekretari i Përgjithshëm, tentoi të pengonte deputetët e opozitës, edhe pse në shkresën e firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm z. Genci Gjoncaj, nuk bëhej fjalë për praninë e deputetëve në komisione hetimore të cilat funksionojnë me ligj të posacëm dhe ka një afat kohe të përcaktuar;
- o Pasi dështoi skenari i ngritur për pengimin e deputetëve të opozitës, Nënkryetari Ndreca urdhëron deputetët e PS që të largohen dhe bojkotojnë mbledhjen e komisionit hetimor;
- o Pas largimit të deputetëve të maxhorancës, Kryetarja e Komisionit znj. Vokshi vijoi mbledhjen e Komisionit. Por në shkelje të përsëritur, shpërdorim të detyrës së tij, Sekretari i Përgjithshëm z. Genci Gjoncaj urdhëron stafin që të ndërpresë sinjalin e transmetimit live ndërkohë që mbledhja vijonte. Kjo pa vënë në dijeni e pa i marrë leje Kryetarit të Komisionit. Ky është një akt i rëndë për parlamentarizmin, ku punojës të administratës vendosin nëse do ketë mbledhje komisioni, nëse do të transpetohet live etj. Pra, administrata është ajo që vendos për funksionimin apo jo të komisioneve në Parlament.
- 8 tetor 2024: punonjësja Vijola Sinaj, e paemëruar në Sekretarinë e Komisionit, dërgon një email te anëtarët e Komisionit Hetimor duke thirrur mbledhjen e Komisionit. Pa shkresa bashkangjitur, pa referenca ligjore, një punonjëse (e panjohur nga ana e deputetëve të komisionit) thërret mbledhjen e Komisionit në datë 9 tetor 2024 (bashkangjitur emaillet e znj. Sinaj);
- 8 tetor 2024: Deputetët e maxhorancës, pa asnjë komunikim me Kryetaren e komisionit, në shkelje të dakordësisë së arritur më parë, thërrasin mbledhjen e Komisionit në datë 9 tetor 2024, me rend të ditës seancë dëgjimore me 5 dëshmitarë drejtues dhe ish drejtues të administratës së Ministrisë së Financave. Kërkesa e firmosur nga ana e disa deputetëve të maxhorancës në Komision, është në shkelje të cdo procedure dhe Nenit 32 pika 2 e Rregullores. Kërkesa e deputetëve të PS nuk i



adresohet Kryetarit të Komisionit, qartazi duke refuzuar njohjen nga ana e tyre të autoritetit të tij dhe drejtimit nga ana e opozitës, e duke tentuar uzurpimin e komisionit dhe vendimmarrjes së tij. Kjo shkresë nuk i ka ardhur në rrugë zyrtare Kryetarit të Komisionit, i cili në bazë të Nenit 32 pika 2 e Rregullores është i detyruar të mbledhë komisionin sipas kërkesës. Ky, është një akt i përsëritur, i qëllimshëm, nga ana e deputetëve të maxhorancës, të cilët kërkojnë të minojnë punën e komisionit e ta dështojnë dhe pengojnë hetimin parlamentar të pengojnë transparencën e dy prej koncesioneve më korruptive në shëndetësi.

- 9 tetor 2024: Deputetët e opozitës, me dëshirën për të vijuar hetimin parlamentar, u paraqitën në mbledhjen e komisionit në orarin e kërkuar.
- o Ne dyert e Komisionit ishin dhjetëra punonjës të gardës të cilët penguan deputetët e opozitës të hynin në sallën ku do të zhvillohej mbledhja e Komisionit Hetimor.
- o Ndërkohë që Kryetarja e Komisionit znj. Vokshi ishte të dera e sallës së Komisionit në orën 11.00, duke debatuar me gardën për të lejuar deputetët e opozitës të hynin në mbledhje, Nënkryetari i Komisionit z. Ndreca, në një akt të turpshëm, skandaloz, në shkelje të ligjit e të rregullores, nisi mbledhjen e Komisionit hetimor.
- o Neni 12 pika 1 e Ligjit për Komisionet Hetimore përcakton: «mbledhjet thirren dhe drejtohen nga Kryetari i Komisionit dhe në mungesë apo në pamundësi nga nënkryetari i komisionit». Kryetarja e Komisionit ishte e pranishme të dera e sallës e penguar nga garda e republikës për të hyrë disa minuta. E në një rast të paprecedent, nënkryetari në një veprim burracak, më nxitim, hileqar, të pamoralshëm, tenton të uzurpojë drejtimin dhe të hapë mbledhjen.
- o Zoti Ndreca mashtrroi publikisht duke thënë që ishte marrë vendim i ndërmjetëm për fillimin e mbledhjes. Nuk ka asnjë vendim të ndërmjetëm e kjo verifikohet lehtë nga proces verbali dhe pamjet filmike te komisionit;
- o Me gjithë kërkesat e Kryetares së Komisionit zj. Vokshi për të nisur mbledhjen sipas ligjit dhe rregullores, nënkryetari i PS z, Ndreca urdhëroi vijimin e saj në mënyrë të paligjshme.
- o Znj Vokshi ka kërkuar për më shumë se tre orë që mbledhja të kthehej në shinat e ligjshmërisë. Ndërkohë, z. Ndreca, z. Metaj kanë ushtruar dhunë verbale dhe psikologjike, kanë fyer, përcmuar, kërcënuar Kryetaren e Komisionit në mënyrë të përsëritur përgjatë gjithë mbledhjes së Komisionit. Për ironi të fatit, asnjë nga zonjat deputete të PS në komision apo jashtë tij, nuk denjoi që të dënonte këtë dhunë verbale nga burrat deputetë të PS, e t'i dilnin në mbrojtje një kolegeje deputete;
- o Gjatë mbledhjes, deputeti Erjon Brace, edhe pse jo anëtar i Komisionit, hyn pa leje, duke bërë titur e duke fyer e kërcënuar Kryetaren e Komisionit znj. Vokshi. Asnjë reagim nga deputetët apo deputetët e maxhorancës për këtë dhunë verbale dhe psikologjike ndaj Kryetares së Komisionit;
- o Në shkelje flagrante të ligjit dhe Rregullores se Kuvendit, që përcakton që është Kryetari që thërret, dhe drejton mbledhjen, z. Ndreca vijoi mbledhjen me dëshmtitarët, në prani në kryetares së Komisionit, duke uzurpuar dhunshëm drejtimin e mbledhjes, duke pyetur dëshmtitarët në kushte jo normale, në kushte tensioni, konflikti, duke bërë që deklaratat të bëhen NUL e të mos jenë referencë në raportin përfundimtar;
- o Znj Vokshi, bazuar në Nenin 122 pika 3 e Rregullores së Kuvendit, i kërkoi në mënyrë të përsëritur punonjësve të Gardës së Republikës të nxirrnin jashtë dëshmtitarin në mënyrë që të fillonte mbledhja e të futej në shinat e ligjshmërisë dhe normalitetit. Por punonjësit e Gardës, në shkelje të Rregullores së Kuvendit, i bindeshin vetëm urdhërave të nënkryetarit të komisionit z. Ndreca, duke injoruar kërkesat e vazhdueshme të Kryetares së Komisionit. Kjo është shkelje flagrante nga ana e



punonjësve të Gardës së Republikës të cilët janë aty jo për t'ju bindur urdhërave të PS, por për të zbatuar Rregulloren e Kuvendit si dhe kryer detyrën e tyre në mënyrë të paanshme e pa kahe politike;

- Përgjatë gjithë zhvillimit të mbledhjes, edhe pse Kryetarja e Komisionit znj. Vokshi nuk kishte thirrur Gardën për të qene prezentë, brenda sallës së mbledhjeve kanë qëndruar 5-6 punonjës të gardës që është shkelje ligjore dhe e Rregullores së Kuvendit, duke krijuar kështu një atmosferë shantazhuese e të papërshtatshme për zhvillimin e mbledhjes dhe marrjen e dëshmimeve.
- Zgjedhja e sallës së mbledhjes bëhet qëllimshëm nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, në mënyrë që të mos i jepet e drejta Kryetarit të Komisionit të drejtojë e të kalojë fjalën sipas procedurës së përcaktuar në rregullore, por i jep mundësinë e ndërhyrjes pa leje të cdo deputeti duke krijuar qëllimshëm kaos, zhurmë, konflikt, gjë që sjell pamundësinë e zhvillimit normal të mbledhjeve të komisionit.

Të gjitha sa më lart, janë dëshmi e qartë e vullnetit të maxhorancës për të penguar mbarëvajtjen e punës së Komisionit Hetimor të Kuvendit për Shërbimet Publike të Sterilizimit dhe Check-up.

Komisioni Hetimor ndodhet në një situatë të paprecedent, të pandodhur asnjëherë më parë në historinë e Komisioneve Hetimore. Mbi 70% e anëtarëve aktualisht janë të «dënuar» e nuk lejohen që të hyjnë e të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit. Theksoj faktin që Komisionet Hetimore funksionojnë më ligj të posacëm, me rregulla të vecanta, e funksionojnë për një afat kohor të caktuar. Ndaj, është e domosdoshme prania e të gjithë anëtarëve të Komisionit siç Seanca Plenare e ka miratuar. Pamundësia e deputetëve për të marrë pjesë në Komision, e bën pyetjen e dëshmitarëve të paplotë, të pavlefshme. Cdo deputet i opozitës ka punuar në mënyrë serioze për të përgatitur pyetjet për secilin prej dëshmitarëve. E asnjërit prej tyre në asnjë rast nuk mund t'i mohohet e drejta për të qenë pjesë e për të trajtuar shqetësimet përkatëse.

Përdorimi nga disa deputete pjese te mazhorances i nje fjalori te padenje dhe joetik ndaj nje zonje deputete, e cila ne rradhe te pare eshte nje nene dhe nje grua, vlerësojmë se përben shkelje te rende te etikes parlamentare. Nisur nga këto shkelje Sekretariati per Procedurat, Votimet dhe Etikën duhet te mblidhet urgjentisht per marrjen e masave te duhura disiplinore te menjëhershme ndaj këtyre deputeteve, ne raport me shkeljen e rende etike qe këta deputete kane konsumuar gjate seancës se Komisionit Hetimor, e transmetuar kjo nga te gjitha kanalet televizive.

Keto ngjarje dhe thënie mund t'i konstatoji lehtësisht nga regjistrimet e seancës së datës 09.10.2024 të Komisionit Hetimor, por edhe nga burime mediatike që kanë pasqyruar incidentet në fjalë.

Nisur nga kjo situatë, ku kemi konstatuar sjellje joparlamentare, gjuhën provokuese dhe intimiduese, aspak etike të përdorur nga Deputeti Erion BRACE, Ilir METAJ dhe Plarent NDRECA ndaj Kryetares se Komisionit Hetimor znj. Albana VOKSHI, gjukojmë se këto sjellje janë të pa tolerueshme dhe të padenja për një ligjvënës.

Ndaj, në mbështetje të Nenit 63, pika “a” dhe Nenit 65/1 i Rregullores së Kuvendit, si dhe Nenit 6 të Kodit të Sjelljes së Deputetit, kërkojmë:

- Marrjen e masave disiplinore : Përgjashtim nga pjesëmarrja në aktivitetin parlamentar për deputetet e Partisë Socialiste z. Erion Brace, z. Ilir Metaj dhe z. Plarent Ndreca;
- Mbledhjen e menjëhershme të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën, për vlerësimin dhe marrjen e masës së propozuar nga ana jonë.

**DEPUTETËT:**

Albanë Vokë M. Pr

Zheni Gjergj G

Elda Hoti

Tona Zhupa

Pjetër Varli

Edmond Spaho Espaho

Jlde Dhoni Gjy

Saimir Fanelis

